



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 152 datë 09.11.2020

PËR

MIRATIMIN E PRISHJES SË DETYRUAR TË NDËRTIMIT, PJESË TË GODINËS NR. 22. BLV. ZOGU I (7 KATËSHI), NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 11, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 35, të Aktit Normativ me nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, shkresës me nr. 213/2 prot, datë 28.01.2020, të Institutit të Ndërtimit drejtuar Bashkisë Tiranë, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtimit, pjesë të godinës nr. 22. BLV. Zogu I (7 Katëshi), në pronësi të Bashkisë Tiranë, ndodhur në rrugën “Bulevardi Zogu I”, për pasuritë me nr. 6/127+1-4; 6/127+1-5; 6/127+1-6; 6/127+1-7, zonë kadastrale 8360, sipas çertifikatave të pronësisë me nr. 1456523, datë 13.10.2020, bazuar në oponencën teknike të akt ekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për aplikimin për leje ndërtimi (prishjen e ndërtimit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore) ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të marrë masat përkatëse për heqjen e objekteve të parashikuara në pikë 1, të këtij vendimi nga bilanci i Bashkisë Tiranë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi që rregullon menaxhimin financiar dhe kontrollin.
5. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.
6. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
7. Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ndjekin procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e ndërtimit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.

8. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet menjëherë edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

9. Ngarkohen Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU